

**PAKR.nr.436/18****NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Have Haliti, kryetare, Xhevdet Abazi dhe Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.I. nga fshati ...-Bashkia e Durrësit, Republika e Shqipërisë, për shkak të veprave penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 11 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë, të përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar av. M.D. dhe mbrojtësit të akuzuarit av. F.Q., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore- Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.369/2017 të datës 05.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 07.12.2018, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me pranimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit L.I. NDRYSHOHET, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.369/2017 të datës 05.06.2018, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarit për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 11 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj, ndërsa, pasi më parë dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, nga gjykata e shkallës së parë, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, e merr si të vërtetuar, me aplikimin e dispozitave të nenit 80 të KPK-së, të akuzuarin e gjykon me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) vjet, me të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.11.2017 e tutje.

Ankesat e prokurorisë dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar, refuzohen si të pabazuara, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar në pjesën tjetër vërtetohet.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr.369/2017 të datës 05.06.2018, i akuzuari L.I., është shpallur fajtor për veprat penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 11 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe për këto vepra penale, pasim më parë i është përcaktuar për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nën par. 11 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj, ndërsa, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet, me aplikimin e dispozitave për shqiptimin e dënimeve për veprat penale në bashkim, bazuar në dispozitat e nenit 80 të KPRK-së, të akuzuarin e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vjet, dënim ky në të cilin është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.11.2017 e tutje.

Të akuzuarin e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 200 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Po ashtu, të akuzuarin e ka obliguar që në emër të Fondit për viktimë të paguajë shumën prej nga 50 € dhe atë në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në procedurë kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore - DKR në Prishtinë, për shkak të vendimit për dënim, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara av. M.D., për shkak të vendimit për dënim dhe vendimit për kërkesën pasurore juridike, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim, ndërsa, përkitazi me vendimin për kërkesën pasurore - juridike, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe i akuzuari të obligohet të paguajë në emër të dëmshpërblimit të dëmtuarve shumën prej nga 86.000 €, secili të dëmtuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.I., av. F.Q., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, në të cilën ishin prezent i akuzuari L.I., mbrojtësi i tij av. F.Q., të dëmtuarit S.G. dhe E.A.,

ndërsa, në seancë edhe pse ishin të ftuar në mënyrë të rregullt, nuk prezantuan Prokurori i Apelit e as përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara. Në seancën e kolegjit të dëmtuarit S.G. dhe E.A., ngelën në tërësi pranë pretendimeve si në ankesën e përfaqësuesit të autorizuar, ndërsa, mbrojtësi i të akuzuarit L.I., av. F.Q. pasi më parë sqaroi disa nga pretendimet ankimore, ngeli në tërësi pranë propozimeve si në ankesë, të cilën e përkrahu edhe i akuzuari L.I..

Prokuroria e Apelit, përmes parashtrësës PPA/I.nr.413/18, të datës 08.11.2018, i ka propozuar gjykatës që ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Prishtinë dhe përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara të aprovohet, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, ndërsa, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuara në ankesë, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit është e bazuar, ndërsa, ato të prokurorisë dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, janë të pabazuara.

Me ankesat e paraqitura edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, pasi që me ankesë nuk është kundërshtuar, prandaj, aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore, pra, përkritazi me vendimin për dënim.

Duke e shqyrtuar çështjen përkritazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të prokurorisë, dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar nuk janë të bazuara, ndërsa, ato të mbrojtësit të akuzuarit janë të bazuara.

Në ankesën e prokurorisë, përkritazi me këtë bazë ankimore theksohet se gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit për dënim ndaj të akuzuarit, nuk ka vepruar drejtë kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënim shumë të butë, ngase, edhe pse i ka konstatuar rrethanat lehtësuese edhe disa nga rrethanat rënduese, prapë se prapë dënimi i shqiptuar është i butë dhe atë sidomos duke marrë parasysh mënyrën se si ka ardhur deri tek kryerja e veprës penale, ku i akuzuari i thërret tani të ndjerit për të biseduar për mos marrëveshjet e tyre dhe me të arritur në vendin e ngjarjes, i akuzuari ka shtënë me armë zjarri, që do të thotë se i njëjti ka planifikuar që më parë kryerjen e veprës penale të vrasjes, prandaj, konstaton se dënimi i shqiptuar është i butë dhe të akuzuarit duhet t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. Gjithashtu, edhe në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, pretendohet se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin si në aktgjykimin e ankimuar, ndërsa, në arsyetim të ankesës përkritazi me këtë, në fillim flitet kryesisht

për gjendjen faktike, për të cilën konstatohet se drejtë e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, duke filluar kështu, pastaj, me paraqitjen e përmbajtjes së deklaratave të dëshmitarëve – të dëmtuarve, deklaratës së vetë të akuzuarit dhe përmbajtjen e provave materiale, ndërsa, përkitazi me vendimin për dënim konstatohet se gjykata e shkallës së parë, vendimin për dënim nuk e ka marrë konform dispozitave ligjore që parashihen për matjen e dënimit, sidomos kur merret parasysh gjendja faktike e konstatuar si në dispozitiv. Më tutje në arsyetim të ankesës, konstatohen rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat gjykata e shkallës së parë, i ka marrë parasysh, kurse në vijim flitet për dispozitat ligjore që rregullojnë mënyrë e shqiptimit të dënimit, ku potencohet sidomos fakti se gjykata duhet së pari të marrë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit, e pastaj, varësisht prej rrethanave lehtësuese dhe rënduese të shqiptojë dënimin, mirëpo, e njëjta – pra, gjykata e shkallës së parë, gjithherë duhet të ketë parasysh faktin se dënimi duhet të jetë së pari në proporcion me peshën e veprës penale, pastaj me sjelljen dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, që në rastin konkret, sipas pretendimeve ankimore, gjykata e shkallës së parë, ka lëshuar të marrë parasysh rrethanat kryesore, sidomos faktin se i akuzuari ka privuar nga jeta dy persona të rinj, pastaj, duke marrë parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, atëherë, pa dyshim që dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është shumë i butë. Ndërsa, në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, përkitazi me këtë bazë ankimore pretendohet se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe atë duke iu dhënë rëndësi sidomos rrethanave lehtësuese, mirëpo, në rastin konkret ka lëshuar të llogarisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, ngase, i akuzuari që në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar, pastaj, pendimin e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale, i cili – pra, i akuzuari, këtë e ka shprehur në mënyrë më të rëndë, ngase, i njëjti gjatë qëndrimit në Itali, për shkak të pendimit të thellë, që ka ndjerë për të ndjerët – pra, privimin nga jeta të dy të rinjve, ka tentuar edhe të bëjë vetëvrasje, për çka edhe ka qëndruar një kohë në trajtim psikiatrik, prandaj, konsideron se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është i ashpër dhe se ka arsye për shqiptimin e një dënimi më të butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh pretendimet ankimore të prokurorisë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar dhe mbrojtësit të akuzuarit, e duke i krahasuar të njëjtat me arsyet e dhëna në vendimin për dënim, nga gjykata e shkallës së parë, atëherë, rezulton se pretendimet e prokurorisë dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i butë, janë të pabazuara, ndërsa, pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i ashpër janë të bazuara.

Pretendimet ankimore të prokurorisë dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar nuk qëndrojnë, për arsye se as nga prokuroria por as nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, nuk cekën rrethana konkrete rënduese që janë evidente e që nuk i ka paraparë gjykata e shkallës së parë, ngase, rrethanat të cilat cekën si rënduese, disa nga to vetëm parafrazohen në mënyrë tjetër nga ajo që i ka marrë parasysh gjykata e shkallës së parë, ndërsa, sa i përket pretendimit se i akuzuari e ka planifikuar që më parë vrasjen e të ndjerëve, një gjë e tillë nuk qëndron për çka më në detaje do flasim gjatë elaborimit të rrethanave lehtësuese, ndërsa, rrethanat

rënduese që cekën nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar janë pothuajse të gjitha rrethanat që gjykata e shkallës së parë, i ka pasur parasysht, ndërsa, disa nga ato që potencohen faktikisht janë elementet përbërëse të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, të njëjtat qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit, ka marrë parasysht rrethanat rënduese dhe lehtësuese, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 73 të KPK-së, mirëpo, kur kemi parasysht pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, atëherë, rezulton se përveç rrethanave lehtësuese, se i akuzuari është i moshës së re, se kryerjes së veprës penale i ka paraprirë mosmarrëveshja për një borxh, se të njëjtit – pra, të akuzuarit në emër të borxhit i është marrë vetura – prona e motrës së tij, se i akuzuari që në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale, ka edhe rrethana tjera lehtësuese që gjykata e shkallës së parë, nuk i ka marrë parasysht edhe atë sidomos faktin se i akuzuari nuk ka qenë personi që i ka pasur borxh tani të ndjerëve, që do të thotë se tani të ndjerit borxhin e personit tjetër e kanë kërkuar nga i akuzuari, pastaj, se borxhi në fjalë, sa herë që ia kanë kërkuar të akuzuarit, e ky – pra, i akuzuari nuk ka pranuar t'ua jap e kanë rritur shumën e borxhit, duke kaluar kështu edhe në fajde, pastaj, se dy herë radhazi para ditës kritike gjatë kërimit të borxhit në fjalë të akuzuarin përveç që e kanë kërcënuar dhe frikësuar, po ashtu, edhe e kanë rrahur, dhe atë në mënyrë më ofenduese duke e goditur me shuplakë si dhe duke i drejtuar revolen në gjoks, pastaj, në emër të borxhit, të akuzuarit ia marrin edhe automjetin që ishte pronë e motrës së tij, dhe atë automjetin në një vlerë shumë më të madhe se borxhi që konsiderohej se ishte në shumë prej 1.800 € ndaj të ndjerëve dhe përfundimisht në momentin kritik të ngjarjes, kur të ndjerët arrijnë në vendin e ngjarjes, në momentin derisa i akuzuari po kalonte rrugën të ndjerët zbresin nga motori dhe me një shpejtësi shkojnë në drejtim të akuzuarit, i cili nga frika dhe shqetësimi, si rezultat i sjelljeve të mëhershme të ndjerëve, i akuzuari nxjerrë revolen dhe fillon të qëllojë në tani të ndjerët, pastaj, duke marrë parasysht edhe faktin se i akuzuari pasi ka kryer veprën penale në fjalë, duke e ndjerë veten emocionalisht në gjendje të rëndë, ka tentuar të bëjë edhe vetë vrasje, atëherë, rezulton se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, është i drejtë dhe i ligjshëm, pastaj është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventivës gjenerale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK-së.

Me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, aktgjykimi i ankimuar kundërshtohet edhe përkitazi me vendimin për kërkesën pasurore-juridike, mirëpo, pretendimet në fjalë nuk qëndrojnë, ngase bazuar në dispozitat e nenit 463 par.2 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë mundë të vendos që të dëmtuarin ta udhëzojë që kërkesën pasurore - juridike ta realizojë në kontest civil, kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë apo të pjesërishtë të kërkesës në fjalë, prandaj në rastin konkret përkitazi me kërkesën në fjalë në mënyrë të drejtë është vendosur nga gjykata e shkallës së parë, kur palët e dëmtuara i ka udhëzuar në procedurë kontestimore.

Nga sa u parashtrua më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E AELIT E KOSOVËS – PRISHTINË**  
**PAKR.nr.436/2018, më dt. 07.12.2018.**

Procesmbajtësja,  
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,  
1. \_\_\_\_\_  
Xhevdet Abazi  
2. \_\_\_\_\_  
Fillim Skoro

Kryetare e kolegjit,  
Have Haliti